



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:230568

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05621717

Rev.nr.168/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Mr.sc.Muhamet Rexha dhe Rrustem Thaqi, anëtarë, në çështjen kontestimore juridike të paditësve R. U. dhe E. S., që të dy nga fshati P., Komuna e P., të cilët me autorizim i përfaqëson Rexhep Fusha, avokat nga P., kundër të paditurës, Komuna e Prishtinës, të cilën e përfaqëson Arber Istrefi, avokat nga P., për kompensimin e dëmit mbi bazën uzurpimit arbitrar, vlera e kontestit 59,900.00 €, duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.10153/2021, datë 23.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, Komuna e Prishtinës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.10153/2021, datë 23.01.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 1724/2012, të datës 05.10.2021, në pikën I të dispozitivit, “ Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R. U. dhe E. Sh. nga fshati P., Komuna e P. dhe detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës, që paditësve R. U. dhe E. S. në emër të kompensimit të dëmit, për marrjen e pronës së paluajtshme në pronësi të paditësve, pjesë të ngastrave kadastrale nga nr. P-.....,,,,, deri në, në sipërfaqe të përgjithshme prej 517 m2, (te cilat gjenden në vendin e quajtur “...”, rr. “....” në P. (të evidentuar në Certifikatën e pronësisë ... ZK P., në të cilën sipërfaqe është ndërtuar rruga

publike "...", e shtruar me asfalt dhe trotuar me kubëza të betonit); t'ua paguaj shumën e përgjithshme në vlerë prej 59,900.00 €, me kamatë sikundër mjetet e qytetarëve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të veçantë nga data 29.06.2012, deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm. Detyrohet e paditura, që paditësve, t'ua paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë të përgjithshme prej 5,339.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.”

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.10153/2021, datë 23.01.2024, refuzohet si e pa themeltë ankesa e paditurës, Komuna e Prishtinës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1724/12, i datës 05.10.2021, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura Komuna e Prishtinës, me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ose të ndryshohen dhe kërkesëpadija e paditësve të refuzohet në tërësi si e pa bazuar..

Të paditurit, përmes të autorizuarit, avokat Rexhep Fusha nga P., kanë paraqitur përgjigje në revizion dhe i kanë kundërshtuar pretendimet e të paditurës, duke kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që revizionin ta refuzoi si të pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës, Komuna e Prishtinës, është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit, më datë 29.06.2015, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me objekt të padisë për kompensimin e dëmit, për shkak të uzurpimit arbitrar të paluajtshmërisë, për nevoja të ndërtimit të rrugës publike. Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave materiale dhe vlerësimit të gjendjes faktike, ka aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësve më gjerësisht si në dispozitiv dhe arsyetim të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës parë në arsyetim të aktgjykimit, ka konstatuar se padia dhe kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, sepse sipas ekspertizës së gjeodezisë të datës 20.01.2020, me konstatimin dhe mendimin e ekspertit Q. H. në parcelat kadastrale ... deri në parcelën kadastrale ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 517 m², e cila gjendet në vendin e quajtur “...”, e që evidentohet ½ në emër të paditësve R. U. dhe E. S., sipas Certifikatës së pronësisë me numër ..., e datës 10.06.2021, Komuna e Prishtinës në cilësinë e investitorit e ka ndërtuar rrugën përgjatë këtyre parcelave kadastrale në sipërfaqe prej 517 m², kjo rrugë është e shtruar me asfalt, dhe trotuari skaj rrugës është ndërtuar me kubëza.

Gjykata, ka konstatuar se Komuna e Prishtinës, kur e ka ndërtuar rrugën në këto pjesë të ngastrave e ka ditur se po ndërton rrugë në pronën e huaj, pa respektuar asnjë procedurë të paraparë me ligj, siç është procedura e shpronësimit dhe kompensimit të pronës, pa pëlqimin e pronarëve, në sipërfaqe prej 517 m² ka ndërtuar rrugë publike. Eksperti A. S. në ekspertizën për vlerësimin e pronave të paluajtshme e datës 06.08.2021 ka vlerësuar, se prona e paluajtshme në sipërfaqe prej 517 m², sipas metodës krahasuese kjo pronë sipas çmimit të përafërt të pronave për 1 m² është 115.82 euro dhe se çmimi i përgjithshëm për 517 m² x 115.82.00 €, është në vlerë prej 59,900.00 €. Gjykata e ka detyruar të paditurën që paditësve t’ua kompensoj dëmin e shkaktuar, në shumën prej 59,900.00 €, sepse janë përmbushur kushtet ligjore dhe atë dëmi është shkaktuar në fajin ekskluziv të paditurës dhe ky dëm është shkaktuar me veprimin e të paditurës dhe se ekziston lidhja kauzale në mes të veprimit të paditurës dhe shkaktimit të dëmit ndaj paditësve. Ekspertizën e gjeodezisë të ekspertit Q. H. dhe Ekspertizën për vlerësimin e pronave të paluajtshme të ekspertit A. S., gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar si prova të pranueshme, të cilat janë hartuar sipas rregullave të shkencës dhe profesionit, po ashtu vlerësimi në konstatim dhe mendim është bërë me përgjegjësi profesionale, ku janë dhënë shpjegime të qarta, të kuptueshme, të plota për rrethanat e ekspertizës.

Gjykata e Apelit e ka aprovuar vlerësimin juridik të Gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e sidomos nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare konform nenit 194 të LPK-së si dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale. Ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës nga neni 182.2 pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadiës e në

lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë dhe i plotë, mungesa e përkufizimeve nuk e bënë të njëjtin të pa përshtatshme, sepse nuk bëhet fjalë për vërtetim pronësie ku do të paraqitej nevoja e regjistrimit, por bëhet fjalë për kompensim dëmi të shkaktuar nga uzurpimi arbitrar i të paditurës, dhe në raste të tilla është e mjaftueshme sipërfaqja e marr pa bazë, dhe pastaj vlerësimi i dëmit apo sipërfaqes së marr, ndërsa aktgjykimi i atakuar në këtë drejtim është i plotë dhe i qëndrueshëm. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apeli, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, sepse në bazë të provave të administruara, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se paditësit janë pronar të pjesëve të ngastrave të cilat e paditura pa bazë pa procedurë të shpronësimit i ka zhveshur paditësit nga prona e tyre, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga ekspertiza e gjeodezisë. Nuk qëndron pretendimi ankimor i përfaqësuesit të paditurës se nuk është e vërtetë se prona paditësve i është marr, sepse e paditura nuk ka realizuar asnjë projekt, ky pretendim bie poshtë në raport me konstatimin e ekspertit të gjeodezisë dhe vlerësimit të pronave, ku madje qartë përcaktohet sipërfaqja e marr, pastaj destinimi i saj për rrugë dhe trotuar si dhe vlera e pronës së marr.

Duke konstatuar se veprimet e të paditurës paraqesin cenim të rëndë të së drejtës së pronës, e mbrojtur me ligj, Kushtetutë dhe Konventë Evropiane për të Drejtat e Njeriut- Protokollin e saj, gjykata e shkallës së dytë e aprovon qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësve si të bazuar, dhe e refuzoi si të pa bazuar ankesën e të paditurës, duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me revizion.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, mbi bazën faktike të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të gjykatës së shkallës së dytë përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, të cilat i pranon edhe gjykata e revizionit, konform dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK-së.

Në revizionin e të paditurës vetëm në mënyrë të përgjithshme thuhet se aktgjykimet e këtyre gjykatave, në këtë çështje konkrete juridike, përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pa u sqaruar konkretisht se cilat janë ato, andaj kjo gjykatë konstaton se janë të pabazuara thëniet në revizion përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale. Kjo për shkak se gjykatat e instancave me të ulëta i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mënyrën e vendosjes meritorë të çështjes kontestuese. Në këtë kontekst, janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritorë, janë dhënë arsye për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të provave të shfrytëzuara.

Në këtë kontekst edhe aktgjykimi i shkallës së dytë në të cilin paraqiten arsyet për konfirmimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm.

Në logjikën e njëjtë është në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozita ligjore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimeve të instancave më të ulëta.

Në revizion, e paditura ka paraqitur thënie dhe pretendime të paraqitura edhe në ankesë dhe gjatë zhvillimit të procedurës në gjykatën e shkallës së parë, për refuzimin e të cilave të dy gjykatat kanë dhënë arsye të mjaftueshme dhe të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit. Për më tepër Gjykata Supreme vlerëson se me provat e administruara në gjykatën e shkallës së parë, në mënyrë të sigurt është vërtetuar se shumica e gjykuar është reale dhe në përputhje me vlerën e tregut në kohën e marrjes. Ekspertet përkatës, në ekspertizën e paraqitur në gjykatë, kanë përdorur metodën e kostos, si metodë më e përshtatshme për vlerësim të pronave objekt i propozimit dhe për të ardhur deri tek rivlerësimi ka marrë për krahasim me pronat e shitura në atë pjesë. Prandaj edhe vlerësimi i

kompensimit sipas Gjykatës Supreme të Kosovës është real dhe i pranon si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, lidhur me vlerësimin e vlerës tokës së përfshirë me shpronësim, dhe detyrimin e të paditurës për pagesën e vlerës reale të tregut të kësaj sipërfaqeje, të paditësve.

Pretendimi i vetëm i revizionit është se kjo ka qenë rrugë edhe më parë por se e njëjta për nevojat e banorëve lokal është zgjeruar. Edhe përkundër faktit se kjo rrugë ka qenë edhe më përpara si e tillë, me rastin e zgjerimit të saj dhe ndërtimit të trotuarit, pa pëlqimin e paditësve është marrë kjo sipërfaqe dhe kjo në asnjë rast nuk kontestohet as nga e paditura. Prandaj ky pretendim i revizionit se u refuzua si pa bazuar.

Përfundimisht, edhe Gjykata Supreme e Kosovës, e aprovon qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë se veprimet e të paditurës, paraqesin cenim të rëndë të së drejtës së pronës, e mbrojtur me ligj, Kushtetutë dhe Konventë Evropiane për të Drejtat e Njeriut- Prokollin e saj. Saktë është zbatuar e drejta materiale, kur është konstatuar se baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjënë mbështetje në nenin 154, 158, 186 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 01 tetor 1978, nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 1 të Protokollit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pra e paditura me marrje të pronës së paditësve, pa procedurë të shpronësimit, ka shkelur nenin 154 të LMD-së, ku përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. “, me nenin 158 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajsia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.“ përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. “, me nenin 158 të këtij ligji, përcaktohet se: “ *Fajsia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.*“, ndërsa me nenin 185 të LMD-së përcaktohet se: “ *Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë kompensim në të holla. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundshme apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që ta bëjë këtë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë dëmtuesit shumën përkatëse në të holla për efekt të kompensimit të dëmit. Gjykata do ti gjykojë dëmtuesit kompensimin në të holla kur ai e kërkon këtë me përjashtim kur rrethanat e rastit konkrete justifikojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme.*“.

Po ashtu kjo gjykatë e provon edhe qëndrimin gjykatës së shkallës së dytë se është cenuar edhe garancia e dhënë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, konkretisht neni 46 paragraf 3, ku përcaktohet se " Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensim ”.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga e paditura nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart, e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.168/2024, datë 22.04.2024

Kryetari i kolegjit,
Beshir Islami